



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
NOTERIA VLORE
NOTERE ALIDA Y. MEMETAJ

Adresa: Rruga "Sulejman Delvina", Lagjia "Hajro Çakemri". VLORE
Tel/Fax: +355 33 408500 Cel: +355 69 696812728 e-mail: alida.memetaj@yahoo.com
VLORE – SHQIPËRI



VERTETIM NENSHKRIMI
(Ne aktet e Shoqerive Tregtare)

Nr.154Rep

Sot ne Vlore ne daten 23.02.2018 ne Vlore, para meje Notere Alida Memetaj me qender prane Gjykates se Rrethit Gjyqesore Vlore, u paraqit personalisht shtetasi,
ne cilesine e Kerkuesit te Aktit:

FABRIZIO CATELLI shtetas Italian, i biri i Aurelio, i datelindjes 13.01.1977, i lindur ne Montichiari (BS), banues ne Montichiari (BS) in Via Padre Annibale di Francia n. 14, mbajtes i Kodit Fiskal CTL FRZ 77A13 F471Q, mbajtes i Kartes se Identitetit Italiane AS9888866, aktualisht banues ne Lagjia "Perlat Rexhepi", Pallati nr.839, Shk.1, Kati 1, Apt.2, me numer pasurie 15/56+1-1, Zone Kadastrale 8602 Vlorë, hyre ne Shqiperi ne date 22.02.2018.

I paraqituri eshte me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, gje per te cilen u sigurova sipas ligjes, i cili ne baze te nenit 39 te Ligjit 7829 dt. 01.06.1994 "Per Noterine" i ndryshuar, ne prani te perkthyeses ligjore **Personi Fizik "REIDONA HAXHIU"** me NIPT K66613202B, me qender prane Gjykates se Rrethit Gjyqesore Vlore, perfaqesuar nga **Reidona Haxhiu** e bija e Pelivan, e datelindjes 20.06.1980, lindur ne Durres, banuese ne Vlore, madhore, e pajisur me Leternjoftim Id Shqiptare Nr.Personal.I05620130C, kerkoi legalizimin e aktit bashkengjitur, "*Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar LEVICA ALB sh.p.k.*" me qender ne Vlorë, te hartuar prej tij personalisht, bashkengjitur dhe perkthimi nga gjuha italiane ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte ligjore .

Te paraqiturit pasi iu lexua akti nga perkthyesia ligjore ne pranine e noteres, duke deklaruar me deshiren dhe vullnetin e tij te lire, te plote dhe te shprehur se eshte plotesisht dakorte me permbajtjen e dokumentit bashkengjitur, e nenshkruan ate pa verejtje ne te dyja format shqip dhe italisht, perpara meje Noteres .

Ne kushte te tilla duke qene se ky akt eshte shprehje e lire e vullnetit te tij dhe pasi u sigurova se u nenshkrua rregullisht ne pranine time, une Noteria vertetoj nenshkrimin e kerkuesit te aktit me firmen time.

NOTERE
Alida MEMETAJ

Alida Memetaj



REPUBBLICA DI ALBANIA
MINISTERO DI GIUSTIZIA
NOTARIATO DI VLORE
NOTAIO ALIDA Y. MEMETAJ

Indirizzo: Rruga "Sulejman Delvina", Lagjia "Hajro Çakerri". VLORE
Tel/Fax: +355 33 408500 Cel: +355 69 696812728 e-mail: alida.memetaj@yahoo.com
VLORE - ALBANIA

AUTENTICA DI FIRMA

(Gli atti di una società commerciale)

Nr. 154 Rep

A Vlore, in giorno odierno li 23.02.2018, in presenza del notaio Alida Memetaj con studio privato presso il Tribunale Distrettuale di Vlore, è comparso personalmente il cittadino:

CATELLI FABRIZIO cittadino italiano, figlio di Aurelio, nato il 13 gennaio 1977 a Montichiari (BS), residente a Montichiari (BS) in Via Padre Annibale di Francia n. 14, titolare del codice fiscale CTL FRZ 77A13 F471Q, recante della carta d'identità italiana AS9888866 attualmente domiciliato in Lagjia "Perlat Rexhepi", P nr.839, Shk.1, Kati 1, Apt.2, proprietà n. 15/56+1-1, are catastale 8602 Vlorë, entrato in Albania il 22.02.2018.

Confermata la propria capacità di intendere e volere, ai sensi di art. 39 della legge n. 7829 del 01.06.1994 "Il Notariato", in persona della traduttrice giurata, persona fisica "REIDONA HAXHIU" p.iva K66613202B, con sede presso il tribunale di Vlore, in persona di Reidona Haxhiu figlia di Pelivan, nata il 20.06.1980, a Durazzo, residente a Vlore, recante della carta di identità albanese con n. Personale 105620130C chiede la legalizzazione dell'atto qui incluso "*Atto di Costituzione e Statuto della società con responsabilità limitata LEVICA ALB sh.p.k*", con sede a Vlore, redatto da lui personalmente allegata anche la traduzione dall'italiano all'albanese con lo stesso valore d'uso.


Letto l'atto al comparente dalla traduttrice giurata, dichiarando lo stesso la propria volontà libera e piena concordanza con l'atto incluso, lo sottoscrive entrambi gli atti in lingua albanese ed italiana in presenza del notaio.

Vista la volontà libera del comparente e la regolare sottoscrizione dello stesso in mia presenza, io Notario autentico la firma del comparente.

NOTAIO

Alida MEMETAJ

(firmato, timbrato)



**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"LEVICA ALB" SHPK**

Ne daten 23.02.2018, une ortaku i vetem themelues
CATELLI FABRIZIO shtetas Italian, i biri i Aurelio, i datelindjes 13.01.1977, i lindur
ne Montichiari (BS), banues ne Montichiari (BS) in Via Padre Annibale di Francia n.
14, mbjates i Kodit Fiskal CTL FRZ 77A13 F471Q, deklaroi se eshte i martuar me
regjim te ndare te ardhurave, mbajtes i Kartes se Identitetit Italiane AS9888866
leshuar ne dt. 02.04.2013 e vlefshme deri ne dt.13.01.2024, hyre ne Shqiperi ne date
22.02.2018.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
(i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Komhëtaxe të
Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të
emërtuar "LEVICA ALB" SH.P.K. (më poshtë referuar si "Shoqëria"). Shoqëria e
themeluar prej meje do të zhvillojë aktivitetin në baze të kërkesave ligjore në fuqi dhe
sipas përmbajtjeve të këtij akti themelimi dhe statuti bashkëngjitur.

Neni 1 EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "LEVICA ALB" SH.P.K.

Neni 2 SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagjia "Perlat Rexhepi", Pallati nr.839,
Shk.1, Kati 1, Apt.2, me numer pasurie 15/56+1-1, Zone Kadastrale 8602 Vlorë.
Asambleja e ortakëve, me qëllim që shoqëria të zhvillojë aktivitetin e saj, mund të
themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si brenda ashtu edhe jashtë
vendit, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër shqiptarë.



Neni 3 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose
prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

Neni 4 OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj: Investimet financiare dhe të shoqërive,
konsulencë menaxheriale dhe të shoqërive, ndertimin, shitjen, dhe menaxhimin e
pasurive të paluajtshme për llogari të vet dhe për pale të treta, shërbime për larjen e
makinaeve, ofiqine mekanike dhe karrocierie, shitjen e aksesoreve dhe pjesëve të
automjeteve, tregti me pakice e karburanteve dhe lubrifikateneve për autotraktore,
konsulencë, zbatim dhemmenaxhim i fushtatave publicitare dhe marketing shqiptarë e
te huaja, menaxhim i hapsirave publicitare, organizim i eventeve për llogari të vet dhe
për pale të treta, menaxhimin e bareve dhe objekteve për ngrenie, shërbim pastrim dhe
pritje, konsulencë për pasurite të paluajtshme, menaxhim i sallave dhe veprimtarive
argetuese, konsulencë imazhi, marrdhenie me publikun, qeradhenie automjeteve,
motorrash, varkave dhe mjeteve ujore me motorr, qeradhenie bicikletash, realizim
sitiesh interneti dhe programeve të menaxhimit, mirembajtje impjantesh për
shpërndarjen e karburanteve, prodhim dhe shitje të veprave të artit, antikuaritit dhe
tapeteve, kerkime në tregun italian dhe të huaj, menaxhim për qeradhenie të argetimit

FABRIZIO CATELLI



menaxhim parqeve ujore, qeradhenia pajisjeve per argetim dhe veprimtarive ujore, menaxhim i llixhave, menaxhim impjanteve sportive, financime te shoqerive, perfaqesim i artisteve dhe sportistev, e-commerce(tregti online) per artikuj te ndryshem, import – eksport i artikujve te ndryshem. Ajo mund te zhvilloje te gjitha veprimtarite tregtare, industriale dhe te paluajtshme te nevojshme dhe/ose te dobishme per permbushjen e objektit te veprimtarise, si dhe te blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufjlve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

Me zgjerimin e aktivitetit shoqëria “LEVICA ALB” shpk ka te drejte te beje shtesa ne objekt ose edhe ndryshime te objektit te veprimtarise se saj, duke kryer respektivisht ndryshimet perkatese ne Statut.

Neni 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakut themelues në vlerën 300.000(treqind mije) Leke i cili është teresisht kapital financiar ne emer te shoqerise qe po themelohet. Pjesemarrja ime si themelues ne kapitalin e shoqerise është ne perputhje me kontributet si me poshte :

Ortaku themelues CATELLI FABRIZIO: Zoterues i 1(nje) kuote me vlere te pergjithshme 300.000(treqind mije) Leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise .

Kontributi i ortakut te vetem është ne para.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

Neni 6 ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbehen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

1.Asamblea e Ortakeve

Ne kuptimin juridik formal Shoqëria “LEVICA ALB” shpk drejtohet nga Asambleja e Pergjithshme Ortakeve. Kompetencat, te drejta dhe detyrat e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve percaktohen ne nenin 81 te ligjit 9901, dt. 28.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar.


Asambleja e Pergjithshme Ortakeve është organi i vetem qe merr vendime dhe miraton cdo ndryshim te statutit, gjithnje sipas modaliteteve qe parashikohen nga ligji. Cdo ndryshim i statutit duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me qellim qe keto ndryshime te pasqyrohen ne regjistrin e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme Ortakeve thirret, mblidhet dhe merr vendime sipas normave qe percaktohen ne ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ”.

Nder te tjera, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, merr vendime per :

- percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- emerimin dhe shkarkimin e administratorit,

FABRIZIO CATELLI



- emërimin, shkarkimin dhe zëvendësimin e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve duke përcaktuar në këtë rast kriteret e likuidimit;
- caktimin e pagave, përfshirë ato të administratorit;
- mbikqyr zbatimin e politikave tregëtare të shoqërisë nga ana e administratorit, përfshirë përgatitjen e bilanceve financiare vjetore dhe raporteve të tjera mbi aktivitetet e shoqërisë.

Gjithë vendimet që merren nga Asambleja e Ortakëve duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve; ato nuk mund të ndryshohen apo fshihen; në vecanti duhet të regjistrohen vendimet, por jo vetëm këto, që lidhen me :

- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet mbi zhvillimin e aktivitetëve të shoqërisë
- shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve
- emërimin, shkarkimin e administratorëve dhe përcaktimin e strukturës së organit administrative;
- ndryshimet e këtij Statuti;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- vendime për ndryshimin e formës së shoqërisë ose ristrukturimin e saj
- vendimet në lidhje me shpërndarjen/prishjen e parakohshme të shoqërisë;
- marrjen dhe transferimin e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera;
- blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme;

Vendimet që nuk janë shkruar në regjistrin përkatës të shoqërisë janë absolutisht të pavlefshme.

2. Organi Administrativ

Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, CATELLI FABRIZIO shtetas Italian, i biri i Aurelio, i datelindjes 13.01.1977, i lindur në Montichiari (BS), banues në Montichiari (BS) në Via Padre Annibale di Francia n. 14, mbajtes i Kodit Fiskal CTL FRZ 77A13 F471Q, mbajtes i Kartës së Identitetit Italiane AS9888866.

Afati emerimit të administratorit është për një periudhë kohore prej 5 (pese) vitesh, me të drejtë ripërtëritje. Emerimi i administratorit do të prodhojë efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

1-Administratori duhet të ushtroj detyrat e ngarkuara, duke respektuar detyrimet e besnikërisë, sipas nenëve 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit no. 9901, datë 14.04.2008.

2-Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim të tij, që lidhet me verpimtarinë e shoqërisë.

3-Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale është i detyruar t'i demshperblej shoqërisë dëm që rrjedhin nga kryerja e shkeljes.

4-Administratori ka barrën e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt .

5-Administratori është Perfaqësuesi Ligjor i shoqërisë.

Neni 7 Prishja e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet :

1. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

FABRIZIO CATELLI




2. me vendim të Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, duke respektuar nenin 87 te Ligjit 9901 "Marrja e vendimeve";
3. me hapjen e procedurave të falimentimit;
4. në se nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3, neni 43 te ligjit nr. 9723, date 03/05/2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
5. me vendim të gjykatës
6. per arsye te tjera te parashikuara ne Statut.

Administratori regjistron prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, ne perputhje me nenin 43 te ligjit no. 99723, date 03/05/2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit

Nese prishja e shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata ne perputhje me nenin 43 te ligjit te Ligjit nr. 9723, date 03/05/2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" ja njofton vendimin kesaj qendre per regjistrim.

Neni 8 Mosmareveshjet

Per mosmareveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmareveshje qe mund te lind midis shoqerise dhe te treteve do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 9 Te Tjera

Per ceshtjet e pavendosura ne Akt Themelimi, do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne Statutin e Shoqerise "LEVICA ALB" shpk, dispozitat e pergjithshme ligjore te ligjit Nr 9901, date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar si dhe dispozitat e pergjithshme ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Akti i themelimit u redaktua ne ne kater kopje te njejta ne gjuhen shqipe dhe Italiane me te njejten vlere ligjore .

Lexuar, pranuar dhe nënshkruar sot me 23.02.2018.

ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "LEVICA ALB" SHPK

CATELLI FABRIZIO

(emer, mbijemer, nënshkrimi)

FABRIZIO CATELLI

FABRIZIO CATELLI



Statuti Bashkëngjitur Aktit të Themelimit datë 23.02.2018 firmosur nga ortaku i vetëm themelues

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR
"LEVICA ALB" Sh.p.k

Ne këtë statut

"Ligji" është Ligji Nr 9901, dt 14,04,2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar .

"Statuti" është Statut i shoqerise

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Selia, Kohëzgjatja

Neni 1

Data e themelimit, themeluesit dhe emri.

Ne daten 23.02.2018, une ortaku i vetem themelues

CATELLI FABRIZIO shtetas Italian, i biri i Aurelio, i datelindjes 13.01.1977, i lindur ne Montichiari (BS), banues ne Montichiari (BS) in Via Padre Annibale di Francia n. 14, mbajtes i Kodit Fiskal CTL FRZ 77A13 F471Q, deklaror se është i martuar me regjim te ndare te te ardhurave, mbajtes i Kartes se Identitetit Italiane AS9888866 leshuar ne dt. 02.04.2013 e vlefshme deri ne dt.13.01.2024, hyre ne Shqiperi ne date 23.02.2018.

Themelohet një shoqëri e së drejtës shqiptare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "LEVICA ALB" sh.p.k.

Neni 2

Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Lagjia "Perlat Rexhepi", Pallati nr.839, Shk.1, Kati 1, Apt.2, me numer pasurie 15/56+1-1, Zone Kadastrale 8602 Vlore.

Asambleja e ortakëve, me qellim qe shoqeria te zhvilloje aktivitetin e saj, mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si brenda ashtu edhe jashte vendit, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër shqiptarë.

Neni 3

Objekti

Objekti / qellimi:

Investimet financiare dhe te shoqerive, konsulence menaxheriale dhe te shoqerive, ndertimin, shitjen, dhe menaxhimin e pasurive te paluajtshme per llogari te vet dhe per pale te treta, sherbime per larjen e makinave, ofiqine mekanike dhe karrocerie, shitjen e aksesorve dhe pjeseve te automjeteve, tregti me pakice e karburanteve dhe lubrifikateneve per autotraktore, konsulence, zbatim dhemmenaxhim i fushtatave publicitare dhe marketing shqiptar e te huaja, menaxhim i hapsirave publicitare, organizim i eventeve per llogari te vet dhe per pale te treta, menaxhimin e bareve dhe objekteve per ngrenie, sherbim pastrim dhe pritje, konsulence per pasurite e paluajtshme, menaxhim i sallave dhe veprimtarive argetuese, konsulenca imazhi, marrdhenie me publikun, qeradhenie automjetesh, motorrash, varkave dhe mjeteve ujore me motorr, qeradhenie bicikletash, realizim sitiesh interneti dhe programeve te

FABRIZIO CATOLU

RETIKONVOKIM I SHK.1
TRANSLATO
IPT 66132

menaxhimit, mirembajtje impjantesh per shperndarjen e karburanteve, prodhim dhe shitje e veprave te artit, antikuariatit dhe tapeteve, kerkime ne tregun italian dhe te huaj, menaxhim parqeve te argetimit, menaxhim parqeve ujore, qeradhenia pajisjeve per argetim dhe veprimitarive ujore, menaxhim i llixhave, menaxhim impjanteve sportive, financime te shoqerive, perfaqesim i artisteve dhe sportisteve, e-commerce(tregti online) per artikuj te ndryshem, import – eksport i artikujve te ndryshem. Ajo mund te zhvilloje te gjitha veprimtarite tregtare, industriale dhe te paluajtshme te nevojshme dhe/ose te dobishme per permbushjen e objektit te veprimtarise, si dhe te bleje pjesemarrje ne kapitalin themeltar te shoqerive te tjera qe kanë objekt te ngjashem apo te perafert me te vetin. Gjithashtu, brenda kufjlve te percaktuar nga ligji mund te lëshojë garanci, letra demshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

Me zgjerimin e aktivitetit shoqëria “LEVICA ALB” shpk ka te drejte te beje shtesa ne objekt ose edhe ndryshime te objektit te veprimtarise se saj, duke kryer respektivisht ndryshimet perkatese ne Statut.

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do te filloj aktivitetin e saj qe nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar .

Kreu II KAPITALI

Kapitali themeltar, Kuotat, Menyra e Blerjes dhe Kalimit te Kuotave, Pasojat e Kalimit, Shtimi dhe Zvoglimi i kapitalit Pjesemarrja e Ortakeve ne Kapitalin Themeltar

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar , kuotat, pjesemarrja e ortakeve


Kapitali i themeltar fillestar i shoqerise eshte 300.000(treqind mijë) Lekë i cili eshte teresisht kapital financiar ne emer te shoqerise qe po themelohet. Pjesemarrja ime si themelues ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet si me poshte :

Ortaku i vetem themelues


- **CATELLI FABRIZIO**: Zoterues i 1(nje) kuote me vlere te pergjithshme 300.000(treqind mijë) Lekë qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut te vetem eshte ne para.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimit të asamblesë së ortakëve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit, ose nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.



FABRIZIO CATELLI



Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e ortakut jashte shoqerise dhe as ortakun nuk pergjigjet personalisht per humbjet e shoqerise mbi kuotat e derdhura nga ai per themelimin e kesaj shoqerie.

Kapitali i shoqerise eshte i pa shlyer.

Neni 6

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të shoqërise e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

Neni 7

Pjesëmarrja e Ortakeve në Kapitalin Themeltar

Pjesëmarrjet e ortakëve në kapitalin themeltar përcaktohen në raport të drejtë me kontributet e tyre në kapitalin themeltar. Të drejtat, përfshirë edhe e drejta e votës, u takojnë ortakëve në mënyrë përpjestimore me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin themeltar. Në rast tjetërsimi të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes. Me "tjetërsim" do të kuptohet çdo akt tjetërsimi i kuotave, në kuptimin më të gjerë të fjalës, si në pronësi të plotë ashtu edhe të pjesshme, që, në mënyrë direkte apo indirekte, sjell ndryshimin e titullit të pronësisë mbi kuotat ose të drejtat mbi to. Ortaku që synon të tjetërsojë, tërësisht ose pjesërisht, kuotat e tij në kapitalin themeltar duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë nëpërmjet një letre rekomande, ofertën e marrë, duke treguar emrin e blerësit të mundshëm dhe kushtet e tjetërsimit, në mënyrë të veçantë çmimin e përcaktuar dhe mënyrën e pagesës (këtu e më poshtë Oferta). Brenda njëzet ditëve nga marrja e komunikimit të Ofertës, ortakët e interesuar në ushtrimin e së drejtës së parablerjes duhet t'i komunikojnë ortakut që kalon të drejtat mbi kuotat, dëshirën për të ushtruar të drejtën e parablerjes, përpjestimisht me pjesëmarrjen e secilit në kapitalin themeltar dhe sipas kushteve të Ofertës, duke shprehur edhe interesin e mundshëm për blerjen e pjesës së kuotave për të cilën nuk është ushtruar e drejta e parablerjes nga ana e ortakëve të tjerë. Është i pavlefshëm çdo komunikim që nuk përmban të gjitha të dhënat e mësipërme. Në rast se ndonjë nga personat që gëzon të drejtën e parablerjes së



FABRIZIO

CATOLU



kuotave, nuk mund ose nuk dëshiron ta ushtrojë atë, e drejta e parablerjes që i takon zmadhohet automatikisht dhe përpjestimisht në favor të ortakëve që kanë shprehur interesin për ta ushtruar këtë të drejtë. Në rast se janë disa ortakë që ushtrojnë të drejtën e parablerjes, kuotat do të shpërndahen ndërmjet tyre në përpjestim me pjesëmarrjen e secilit në kapitalin themeltar të shoqërisë. Në rast se në letrën e komunikimit të Ofertës tregohet si blerës i mundshëm një person që është ortak, edhe atij i njihet e drejta e parablerjes, krahas ortakëve të tjerë.

E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet për të gjithë pjesëmarrjen e ofruar dhe për çmimin e përcaktuar, duke qenë se i tillë është objekti i propozimit të paraqitur nga ortaku ofrues. Në rast se çmimi vlerësohet tepër i lartë nga ndonjëri prej ortakëve që ka shprehur, në afatet dhe mënyrat e mësipërme, dëshiren për të ushtruar parablerjen, çmimi i tjetërsimit do të përcaktohet nga palët me marrëveshje të përbashkët ndërmjet tyre. Në rast se nuk arrihet asnjë marrëveshje, çmimi do të përcaktohet nëpërmjet raportit të ekspertit të emëruar nga palët me marrëveshje ose, në rast mosmarrëveshjeje, të caktuar nga Gjykata kompetente. Në kryerjen e vlerësimeve të tij, eksperti duhet të ketë parasysh situatën pasurore të shoqërisë, të rentabilitetit të saj, të vlerës së pasurive materiale dhe jomateriale që ajo posedon, të pozicionit të saj në treg si dhe të çrnimit dhe kushteve të ofruara nga blerësi potencial, nëse ky është me mirëbesim, si dhe çdo rrethanë apo kusht tjetër që merret formalisht në konsideratë për caktimin e vlerës së pjesëmarrjeve në kapitalin themeltar të shoqërisë. Në rastin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes, nënshkrimi kontratës së shitjes së kuotave dhe pagesa përkatëse duhet të kryhen brenda afateve të përcaktuara në propozimin e shitjes së formuluar nga ortaku ofrues. Nëse e drejta e parablerjes nuk ushtrohet brenda afateve të mësipërme dhe për tërësinë e pjesëmarrjes së ofruar, ortaku ofrues mund t'i transferojë kuotat e veta në favor të blerësit të treguar në komunikimin e Ofertës dhe në kushtet e parashikuara në të brenda gjashtedhjetë ditëve të ardhshme. Në të kundërt, procedura e parablerjes duhet të përsëritet. Në rast tjetërsimi të kuoatve në favor të të tretëve, pa zbatuar dispozitat e parashikuara më sipër, blerësi nuk do të legjitimohet në ushtrimin e të drejtave administrative dhe pasurore dhe tjetërsimi i kuotave nga ana e tij nuk do të prodhojë efekte ndaj shoqërisë. Nëse asnjëri prej ortakëve nuk e ushtron të drejtën e parablerjes në mënyrat e përcaktuara, ortaku ofrues mund të nënshkruajë aktin e shitjes së pjeses së tij në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

KREU III


Organet Vendimmarrese dhe Drejtuese të Shoqërisë Asamblea Përgjithshme e Ortakëve, Administratori, Perfagesimi

Neni 8


Asamblea e Përgjithshme Ortakëve

Asamblea Përgjithshme e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarres i shoqërisë. Kompetencat, të drejta dhe detyrat e Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve përcaktohen në nenin 81 të ligjit 9901, dt. 28.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Asamblea e Përgjithshme Ortakëve është organi i vetëm që merr vendime dhe miraton çdo ndryshim të statutit, gjithnjë sipas modaliteteve që parashikohen nga ligji. Çdo



FABRIZIO CATOLU



ndryshim i statutit duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me qellim qe keto ndryshime te pasqyrohen ne regjistrin e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme Ortakeve thirret, mblidhet dhe merr vendime sipas normave qe percaktohen ne ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregetare".

Nder te tjera, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, merr vendime per :

- percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- emerimin dhe shkarkimin e administratorit
- emërimin, shkarkimin dhe zëvendësimin e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve duke percaktuar në këtë rast kriteret e likuidimit;
- caktimin e pagave, perfshire ate te administratorit
- mbikqyr zbatimin e politikave tregtare te shoqerise nga ana e administratorit, perfshin pergatitjen e bilanceve financiare vjetore dhe raporteve te tjere mbi aktivitetet e shoqerise

Gjithe vendimet qe merren nga Asambleja e Ortakeve duhet te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve; ato nuk mund te ndryshohen apo fshihen; ne vecanti duhet te regjistrohen vendimet, por jo vetem keto, qe lidhen me :


- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet mbi zhvillimin e aktiviteteteve te shoqerise
- shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve
- emerimin, shkarkimin e administratorëve dhe percaktimin e strukturës së organit administrative;
- ndryshimet e këtij Statuti;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- vendime per ndryshimin e formës së shoqërisë ose ristrukturimin e saj
- vendimet në lidhje me shpërndarjen/prishjen e parakohshme të shoqërisë;
- marrjen dhe transferimin e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera;
- blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme;

Vendimet qe nuk jane shkruar ne regjistrin perkates te shoqerise jane absolutisht te pavlefshme.


Neni 9

Marrja e vendimeve dhe menytrat e thirrjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e ortakëve e thirrur rregullisht përfaqëson bashkësinë e ortakëve dhe vendimet e saj, të marra në përputhje me ligjin dhe këtë statut, janë të detyrueshme për të gjithë ortakët, edhe nëse këta mungojnë ose nuk janë të të njëtit mendim. Asambleja e ortakëve thirret me njoftim dërguar ortakëve në vendbanimin e tyre ose në adresën e postës së tyre elektronike dhe i marrë prej këtyre të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë. Në njoftimin e thirrjes duhet të tregohen vendi, dita dhe ora e mbledhjes dhe lista e çështjeve në rend të ditës. Në rast mosrespektimi të formaliteteve të mësipërme, asambleja do të konsiderohet e thirrur rregullisht vetëm nëse është e përfaqësuar tërësia e kapitalit themeltar dhe asnjë nuk kundërshton diskutimin e çështjeve në rend të ditës. Asambleja drejtohet nga Administratori. Drejtuesi i Asamblesë konstaton mbledhjen e rregullt të saj, verifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, drejton dhe garanton zhvillimin e rregullt të asamblesë si dhe verifikon dhe shpall rezultatet e votimeve.



FABRIZIO CATOLINI



Mbledhjet e Asamblesë së ortakëve mund të mbahen edhe nëpërmjet video-konferencës dhe tele-konferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe të dallohen në çdo moment të lidhjes, dhe t'u lejohej të ndjekin diskutimin, të marrin, dërgojnë dhe vëzhgojnë dokumentat, të ndërhyjnë gojarisht dhe në kohë reale mbi të gjitha çështjet, si dhe të marrin pjesë në votim dhe të vendosin, në mënyrë të tillë që të mund të garantohet metoda kolegjiale dhe zbatimi i parimeve të mirëbesimit dhe barazisë së trajtimit të ortakëve. Në prani të kushteve të mësipërme, asambleja e ortakëve konsiderohet e mbajtur në vendin në të cilin gjendet drejtuesi i saj.

Vota duhet të jetë e hapur ose gjithsesi të shprehet me modalitete të tilla që bëjnë të mundur identifikimin e ortakëve që nuk janë të njëjtit mendim. Modalitetet e votimit miratohen nga asambleja e ortakëve me shumicën e të pranishmëve, mbi propozim të administratorit. Në rast se nuk parashikohet ndryshe me ligj, pjesët e kapitalit themeltar për të cilat nuk mund të ushtrohet e drejta e votës do të llogariten për efekt të kuoromit të nevojshëm për mbledhjen e vlefshme të asamblesë. Vendimet e asamblesë së ortakëve duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes të nenshkruar nga drejtuesi. Procesverbalit të asamblese i bashkangjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimet perkatëse.

Asambleja e Përgjithshme Ortakëve vendos me $\frac{3}{4}$ (tri të katërtat) e votave të ortakëve, siç përcaktohet në nenin 87 të ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Neni 10

Votat e Ortakëve

Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuota, kuota i jep ortakut apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e pjesëmarrjes dhe të votës në asamble në përpjestim me pjesëmarrjen që zotëron në kapitalin themeltar. Ortakët mund të përfaqësohen në asamble nga persona të tjerë nëpërmjet prokurës së posaçme. Prokura është e vlefshme vetëm për asamblenë për të cilën lëshohet, të identifikuar sipas rendit të ditës. Ortakët nuk mund të përfaqësohen nga administratori i shoqërisë.


Neni 11

Përfashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortakut perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, rashtu si ortakut te cilin perfaqeson.



FABRIZIO CATO



Neni 12

Administratori, afati, detyrat

Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm , qe eshte z.Catelli Fabrizio shtetas Italian, i biri i Aurelio, i datelindjes 13.01.1977, lindur ne Montichiari (BS), mbajtes i Kartes se Identitetit Italiane AS9888866, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

CATELLI FABRIZIO

Lagjia “ Perlat Rexhepi”

Pallati nr.839, Shk.1, Kati 1, Apt.2

nr.pasurie 15/56+1-1, z.k. 8602

Vlore

Karte Identiteti Italiane

Nr.AS9888866.

Specimeni i nenshkrimit

Afati emerimit te administratorit eshte per nje periudhe kohore prej 5(pese) vitesh, me te drejte ripërtëritje.

Emerimi i administratorit do te prodhoj efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.


Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që ligji, akti i themelimit dhe statuti i rezervojnë asamblesë së ortakëve. Administratori gëzon të drejta dhe fuqi të plota për kryerjen e çdo veprimi dhe/ose operacioni që vlerëson të dobishëm për realizimin e objektit të shoqërisë. Përpos asaj çka parashikohet nga ligji administratori ka detyrën e kryerjes së veprimeve të mëposhtme:

1. Te kryej gjithe veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise , duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asamblea e Pergjithshme Ortakeve.
2. Te perfaqesoje shoqerine tregtare.
3. Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise.
4. Te pergatise dhe nenshkruaj bilancin vjetor, raportin e ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, paraqitjen e ketyre dokumentave Asamblese se Pegjithshme te Ortakeve per miratim.
5. Te krijoj nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
6. Te kryej regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic percaktohet ne ligjin “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”.
7. Te raportoj perpara Asamblese Pergjithshme te Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme, me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
8. Te kryej detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.


Administratorët mund të delegojnë përfaqësues të posaçëm për kryerjen e akteve të veçanta ose të një kategorie aktesh, duke përcaktuar kompetencat përkatëse.

Asamblea e Pergjithshme e Ortakeve mund ta shkarkoje administratorin ne cdo kohe. Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te kufizojne kete te drejte.

Shperblimi administratorit percaktohet me vendim te zakonshem te ortakeve.



FABRIZIO CATELLI



Administratori mund te heqe dore ne cdo kohe nga detyra e tij nepermjet nje njoftimi me shkrim drejtuar asamblese se pergjithshme te ortakeve perpara dates ne te cilen hyn ne fuqi doreheqja e tij.

Doreheqja e administratorit nuk cenon padite e shoqerise per shkelje te detyrimit te besnikerise qe administratori ka ndaj saj.

Neni 13

Detyrimi besnikerise dhe pergjegjesia

Administratori duhet te ushtroj detyrat e ngarkuara, duke respektuar detyrimet e besnikerise, sipas neneve 14,15,17 dhe 18 te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare".

Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim te tij, qe lidhet me verpimtarine e shoqerise.

Nese administratori vepron ne kundersizhtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar t'i demshperblej shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes.

Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tij ne menyre te rregullt.

Neni 14

Perfaqesimi

Administratori ka te drejten e perfaqesimit te shoqerise kundrejt te tretëve dhe në gjykim. Ai mund të caktojë avokatë dhe përfaqësues të shoqerisë përpara organëve gjyqësore, organeve të administratës shtetërore dhe të tretëve, si dhe përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose kategori aktesh. E drejta e firmës së shoqerisë mund të ushtrohet edhe nga personat të cilëve u eshte deleguar kjo e drejte brenda kufijeve te kompetencave te dhena. Administratori ka te drejten e rimbursimit te shpenzimeve te bera gjate ushtrimit te funksioneve si dhe nje shperblim vjetor te percaktuar nga asambleja e ortakeve ne momentin e emerimit ose me vendim te posacem.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "LEVICA ALB" sh.p.k perfaqesohet nga administratori emeruar i saj z. CATELLI FABRIZIO.

Administratori eshte perfaqesuesi ligjor i shoqerise

Veprimet e kryera nga perfaqesuesi ligjor i shoqerise jane te detyrueshme per shoqerine, edhe nese keto tejkalojne objektin e saj, me perjashtim te rastit kur keto veprime shkojne pertej tagrave te perfaqesimit qe u jep ligji.

KREU IV

Viti financiar, fitimet, financimet e ortakeve, prishja e shoqerise,regjistrimi i prishjes

Neni 15

Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon ne daten 1 Janar dhe mbyllet ne daten 31 Dhjetor; ben perjashtim viti i pare ushtrimor, i cili fillon ditën e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit .



FABRIZIO CATELLI

Në mbyllje të çdo viti ushtrimor, organi administrativ harton bilancin e vitit ushtrimor, brenda afateve dhe në përputhje me dispozitat e ligjit. Bilanci mund t'u paraqitet ortakëve për miratim brenda njëqindetëdhjetëditëve nga mbyllja e vitit ushtrimor. Dokumentat e kontabilitetit, të shoqëruara nëse e nevojshme nga relacioni i ekspertëve kontahël të autorizuar, duhet t'u komunikohen ortakëve dhe të vihen në dispozicion të tyre pranë selisë së shoqërisë, të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë.

Neni 16 Fitimet

Fitimet që rezultojnë nga bilanci ushtrimor do të shpërndahen ndërmjet ortakëve pasi të jenë zhritur nga kjo shumë vlera e humbjeve të pësuar gjatë vitit ushtrimor si dhe 5% (pesë për qind) që destinohet për fondet e rezervës së domosdoshme, derisa kjo të ketë arritur kufirin e parashikuar me ligj. Pjesa që mbetet pas zbritjes së zërave të mësipërm, do t'u shpërndahet pronarëve të kuotave të kapitalit themeltar përpjestimisht me pjesëmarrjet e tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, me përjashtim të destinimit të ndryshëm të vendosur nga vetë ortakët.

Neni 17 Financimi i Ortakëve

Shoqëria mund të marrë nga ortakët financime me ose pa shpërblim, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Dhënia e këtyre financimeve nga ana e ortakëve është e lirë.


Neni 18 Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjesi të kufizuar priset :

1. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
2. me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve, duke respektuar nenin 87 të Ligjit 9901 "Marrja e vendimeve";
3. me hapjen e procedurave të falimentimit;
4. nëse nuk ka kryer veprimtari tregëtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me piken 3, neni 43 të ligjit nr. 9723, datë 03/05/2007 "Për Qendren Komëtare të Regjistrimit".
5. me vendim të gjykatës
6. për arsye të tjera të parashikuara në Statut.

Neni 19 Shpërndarja e parakohshme dhe Likuidimi i Shoqërisë

Shpërndarja e parakohshme e shoqërisë vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicat e parashikuara për ndryshimin e këtij statuti, në rastet e parashikuara nga ligji. Në rast se realizohet ndonjëri nga shkaqet që sjell shpërndarjen e shoqërisë, asambleja e ortakëve, me vendim të posaçëm të marrë gjithmonë me shumicat e parashikuara për ndryshimin e statudit, do të përcaktojë modalitetet e likuidimit në



FABRIZIO CATOZZI

gjendjen e aftesise paguese, sipas neneve 190 deri 205 te Ligjit nr. 9901, date 14/04/2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", dhe do të emërojë një ose disa likuidatorë duke përcaktuar njëkohësisht edhe kompetencat përkatëse. Shoqëria mund të anullojë në çdo moment gjendjen e likuidimit, me vendim të asamblesë të marrë me shumicat e parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

Neni 20

Regjistrimi prishjes se shoqerise

Administratori regjistron prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr.9723, date 03/05/2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Nese prishja e shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata ne perputhje me nenin 43 te ligjit te Ligjit nr. 9723, date 03/05/2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit " ja njofton vendimin, kesaj qendre per regjistrim.

KREU V

Mosmareveshjet dhe dispozita perfundimtare

Neni 21

Mosmareveshjet

Per mosmareveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmareveshje qe mund te lind midis shoqerise dhe te treteve do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 22

Dispozita perfundimtare

